



# MANUAL TRAJNIMI “PARANDALIMI I EKSTREMIZMIT TE DHUNSHEM”



14-18 MAJ 2018  
DURRES, GOLEM  
OPEN DOOR

## TABELA PËRMBLEDHËSE

KAPITULLI I .....	4
ÇËSHITJE TË LIDHURA ME RADIKALIZMIN, EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM, TERRORIZMIN .....	4
1.1 PËRKUFIZIMI I TERMAVE.....	4
1.2 FORMAT E SHFAQJES SË EKSTREMISMIT TË DHUNSHËM.....	5
1.2.1 TERRORIZMI NDËRKOMBËTAR .....	6
1.2.3 KONCEPTI HISTORIK MBI TERRORIZMIN .....	6
1.2.4 EKSTREMIZMI I DHUNSHËM NË FAMILJE.....	9
1.2.5 KRIMET E URREJTJES .....	9
1.3 MODELET E SJELLJES .....	10
1.4 FORMAT KRYESORE TË EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM .....	11
1.5 SHKAQET E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM.....	11
KAPITULLI II .....	13
FAKTORËT E REZIKUT TEK TË RINJTË.....	13
2.1 KATALIZATORËT QË DREJTOJNË EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM .....	13
2.1.1 PSE RREZIKOJNË TË REKRUTOHEN TË RINJTË? .....	13
2.1.2 FAKTORËT E RREZIKUT PËR ADOLESHENTËT .....	13
2.1.3 FAKTORËT E RREZIKUT MJEDISOR.....	14
2.1.4 FAKTORËT E RREZIKUT `TË HYRJES` .....	14
2.1.5 MEDIA SOCIALE .....	15
2.1.6 PROPAGANDA E DHUNSHME.....	15
2.1.7 LOJA.....	16
2.2 FORMAT E SHFAQJES SË DHUNËS.....	16
2.2.1 IDENTIFIKIMI I TË RINJVE NË RREZIK.....	18
2.3 KONFLIKTI, KUPTIMI I TIJ DHE AFTËSITË JETËSORE OSE TË BUTA. PARANDALIMI DHE MENAXHIMI I FORMAVE EKSTREME TË DHUNËS .....	20
2.3.1 PARAGJYKIMI, DISKRIMINIMI DHE KONFLIKT NDERMJET GRUPEVE .....	20
2.3.2 PERSONALITETI AUTORITAR.....	20
2.3.3 PARAGJYKIMET DHE STEROTIPET .....	20
2.3.4 TEORIA E DEPRIVIMIT RELATIV .....	21
2.3.5 PARAGJYKIMI SI FENOMEN I PERFSHIRJES NE NJE GRUP .....	21
2.3.6 TEORIA E KATEGORIZIMIT TE VETES .....	22
2.3.7 HIPOTEZA E KONTAKTIT .....	22
2.3.8 RIKATEGORIZIMI .....	22
2.4 ÇFARË NJIHET ME AFTËSI JETËSORE OSE TË BUTA?.....	22
2.4.1 PËRFITIMET NGA AFTËSITË JETËSORE.....	23

KAPITULLI 3 .....	25
SHKOLLA SI QËNDËR KOMUNITARE .....	25
3.1 ÇFARË ËSHTË SHKOLLA SI QËNDËR KOMUNITARE? .....	25
3.1.1 VEÇORITË E SHKOLLËS SI QENDËR KOMUNITARE.....	25
3.1.2 PSE NGRIHEN SHKOLLAT SI QENDRA KOMUNITARE?.....	25
3.1.3 PARIMET BAZË QË UDHËHEQIN SHKOLLËS SI QENDËR KOMUNITARE.....	26
3.1.4 VEPRIMTARI TË SHKOLLËS SI QENDËR KOMUNITARE .....	26
3.2. Ç’JANË STANDARDET E SHKOLLËS SI QENDËR KOMUNITARE? .....	27
3.2.1 PSE NEVOJITEN STANDARDET E SHKOLLËS SI QENDËR KOMUNITARE.....	28
3.2.2 FUSHAT E STANDARDEVE.....	28
3.2.4 STANDARDET E SHKOLLËS SI QENDËR KOMUNITARE.....	28

“Ky dokument është prodhuar në kuadër të projektit “**A Caravan for social challenges! Acaravan for your empowerment!**” i zbatuar nga “**Open Doors**” mbështetur financiarisht nga projekti “**Shoqëria Civile kundër Ekstremizmit të Dhunshëm**” i cili finanohet nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Open Doors dhe në asnjë rast nuk reflekton apo përfaqëson domosdoshmërisht mendimin apo qëndrimin e KSHH-së dhe as të Bashkimit Evropian”



## KAPITULLI I

### ÇËSHTJE TË LIDHURA ME RADIKALIZMIN, EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM, TERRORIZMIN

#### 1.1 PËRKUFIZIMI I TERMAVE

- ❖ **Radikalizëm-** atëhere kur besimet e një personi lëkunden nga relativisht konvencionale në radikale dhe kur dëshirojnë një ndryshim drastik në shoqëri. Kjo nuk është domosdoshmërisht diçka e keqe dhe nuk nënkupton detyrimisht dhunën. Megjithatë, mund të kthehet në një shqetësim për të gjithë, duke përfshirë këtu familjen, komunitetin dhe ligjin, nëse një person fillon të mbrojë ose përdor dhunën për të arritur një qëllim politik, fetar ose ideologjik.

Radikalizimi është një proces kompleks që përfshin njerëz të një larmishmërie etnike, kombëtare, politike dhe fetare. Procesi përfshin një sërë vendimesh të cilat, në rethana të caktuara, përfundojnë në një akt ekstremizmi të dhunshëm. Personat radikal zhvillojnë qëndrime dhe sjellje që kërkojnë në thelb transformimin e natyrës së shoqërisë dhe qeverisjes. Këto qëndrime ndryshojnë shumë nga shumica e anëtarëve të shoqërisë. Në të shumtën e rasteve një sjellje e tillë nuk paraqet rrezik, megjithatë, kur një person radikalizon në pikën që justifikon, promovon ose kërcënon me dhunë nën synim e arritjes së qëllimit të tij, si komuniteti ashtu edhe qeveria janë përgjegjës për të vepruar.

- ❖ **Ekstremizmi i dhunshëm-** lidhet me ato besime dhe veprime që mbështesin ose përdorin dhunën e motivuar ideologjikisht për të ngulitur pikëpamje ideologjike, fetare ose politike radikale. Pikëpamjet e ekstremizmit të dhunshëm mund të shfaqen në një sërë çështjesh, duke përfshirë marrëdhëniet politike, fetare dhe gjinore. Asnjë shoqëri, komunitet fetar ose pikëpamje botërore nuk është immune ndaj një ekstremizmi të tillë të dhunshëm. Ekstremizmi i dhunshëm është situata kur “ti nuk lejon pikëpamje të ndryshme; kur mendon se pikëpamjet e tua janë të veçanta, kur nuk lejon mundësinë e të ndryshmes dhe kur do t'ua imponosh idetë e tua të tjerëve, nëse është e nevojshme, edhe përmes dhunës.”

**Faktorët shtytës-** që i drejtojnë individët drejt ekstremizmit të dhunshëm, janë të tillë si: marxhinalizimi, pabarazia, diskriminimi, persekutimi ose perceptimi i persekutimit; mundësia e kufizuar për arsim cilësor dhe të përshtatshëm; mohimi i të drejtave dhe lirive civile; dhe probleme të tjera mjedisore, historike dhe social-ekonomike.

**Faktorët tërheqës-** që ushqejnë tërheqjen ndaj e ekstremizmit të dhunshëm, janë të tillë si: ekzistenca e grupeve të mirëorganizuara të ekstremizmit të dhunshëm me ligjërimi imponuese dhe programe efektive, të cilat ofrojnë shërbime, të ardhura dhe/ose punësim në këmbim të anëtarësimit. Grupet mund të joshin anëtarë të rinj duke iu ofruar zgjidhje për problemet dhe duke iu premtuar aventurë dhe liri. Për më tepër, këto grupe duket se ofrojnë rehati shpirtërore, “ndjenjën e përkatësisë” dhe një rrjet social mbështetës.

- ❖ **Terrorizmi**- sipas Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së për vitin 1995 referohet si: një veprim kriminal i parashikuar ose i përlogaritur për të provokuar një gjendje terrori ndaj publikut të gjerë, një grupi personash apo personave të veçantë për qëllime politike.

Terrorizmi karakterizohet nga tre elemente kryesore:

- ✓ Dhunë e qëllimshme ose kërcënim i qëllimshëm me dhunë
- ✓ Targetim i qëllimshëm i civilëve
- ✓ Objektiva politik

Terrorizmi përfshin "vepra kriminale që synojnë ose llogariten të provokojnë një gjendje terrori në publikun e gjerë, tek një grup personash ose individë të veçantë për qëllime politike dhe se veprime të tilla janë në çdo rrethanë të pajustificueshme, pavarësisht pikëpamjeve politike, filozofike, ideologjike, raciale, etnike, fetare ose natyrore që mund të thirret për t'i justifikuar ato.

Terrorizmi gjithashtu synon shkatërrimin e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe ligjit. Të drejtat e njeriut janë vlera universale dhe garanci ligjore që mbrojnë individët dhe grupet kundrejt veprimeve ose mosveprimeve kryesisht nga agjentët shtetëror që ndërhyjnë me liritë themelore, të drejtat dhe dinjitetin njerëzor. Spektri i plotë i të drejtave të njeriut përfshin respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave civile, kulturore, ekonomike, politike, sociale, si dhe të drejtën për zhvillim. Të drejtat e njeriut janë universale - me fjalë të tjera, i përkasin në thelb të gjitha qenieve njerëzore – dhe janë të ndërvarura dhe të pandashme.

Nisur nga sa thamë, terrorizmi ka një ndikim të drejtpërdrejtë mbi një numër të madh të drejtash të njeriut, në veçanti e drejta për jetën, lirinë dhe integritetin fizik. Aktet terroriste mund të destabilizojnë qeveritë, të minojnë shoqërinë civile, të rrezikojnë paqen dhe sigurinë, të kërcënojnë zhvillimin social dhe ekonomik dhe mund të ndikojnë tejet negativisht në grupe të caktuara. Të gjitha këto kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në garantimin e të drejtave themelore të njeriut.

## 1.2 FORMAT E SHFAQJES SË EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Në vitet e fundit, komunitetet lokale janë vënë në shënjestër të një numri të madh aktesh ekstremiste, përfshirë këtu aktivitete terroriste, banda, kriminelë, trafikim qëniesh njerëzore dhe grabitje online. Motivët pas këtyre akteve sugjerojnë përfitimet financiare, çështje personale ose ideologjike, ose shtysa tek të rinjtë vulnerabël. Ndërsa këto kërcënime evoluojnë brenda komuniteteve tona, edhe korresponduesi i tyre brenda shkollave tona gjithashtu evoluon. Programe kundra ekstremizmit të dhunshëm adresojnë të tilla çështje. Misioni i tyre është identifikimi i katalizatorëve dhe aryjeve që motivojnë individët për të advokuar kundra dhunës si një zgjidhje ndaj ankesave dhe që mundëson sjellje alternative që udhëheqin individët drejt një rruge më pak shkatërruese. Në këtë kuadër, mund të diskutohen tri kategori kryesore të dhunës së motivuar ideologjikisht: terrorizmi ndërkombëtar, lëvizjet ekstremiste të dhunshme në familje dhe krimet e urrejtjes.

### 1.2.1 TERRORIZMI NDËRKOMBËTAR

**Organizatat e huaja të terrorizmit:** këto janë organizata që mbrojnë dhunën ose kryejnë veprimtari të dhunshme kundër interesave të vendeve. Të tilla janë organizatat terroriste që vazhdojnë të planifikojnë operacione nga jashtë kundër interesave të SHBA dhe të aleatëve të tyre. Që nga 11 shtatori, përpjekjet e qeverisë së SHBA për të prishur dhe shkatërruar aktivitetet terroriste të Al-Kaidës çuan në rezultate të suksesshme por organizatat terroriste janë ende një kërcënim i qëndrueshëm dhe i vazhdueshëm. Panorama e terrorizmit ndërkombëtar të kontrolluar dikur nga Al-Kaida tani dominohet nga Shteti Islamik në Irak dhe Levant (ISIL). Shfaqja dhe rritja e ISIL-it po kërcënon kufijtë e këtij vendi dhe të rinjve, të cilët janë fokusi i parë i përpjekjeve të rekrutimit të ISIL-it.

### 1.2.3 KONCEPTI HISTORIK MBI TERRORIZMIN

Ironikisht, kur terrorizmi fillimisht u shfaq në fund të shekullit të 18-të në kohën e Revolucionit Francez, ishte një term që në fakt shoqërohej me origjinën e demokracisë dhe nuk kishte asnjë nga konotacionet negative apo prerogativat që ka sot terrorizmi. Përkundrazi, ai u pa si lindja e demokracisë, me fundin e sundimit monarkik, me në thelb me vendosjen e sundimit nga populli. Aktivitetet e tij u shoqëruan pothuajse ekskluzivisht me qeverinë, me zyrtarë qeveritarë, ndryshe nga sot kur terrorizmi shihet si një fenomen jo shtetëror ose si akt dhune që kryehet nga grupe njerëzish. Konotacionet pozitive të terrorizmit përfunduan në korrik 1794, kur Robespierre, udhëheqësi i Revolucionit Francez, mbajti një listë të tradhtarëve që ai tha se e kishin minuar revolucionin. Në këtë kontekst terrorizmi u zhvendos më shumë drejt konotacioneve negative që kemi sot. Terrorizmi pra, u pa si diçka jo pozitive dhe jo e mirë dhe si diçka që ishte dukshëm negative, abuzive dhe që sigurisht përfshinte dhunën e shkaktuar ndaj njerëzve të zakonshëm. Pra, terrorizmi rishfaqet si një koncept dhe si një mjet revolucionari ose një mjet për të arritur ndryshime thelbësore politike në mes të shekullit të 19-të. Më pas ai ju atashua dy lëvizjeve të veçanta, të dyja konsekuenca të Revolucionit Francez. Nga njëra anë, kemi organizatat revolucionare anti-monarkike që kërkonin të përmbysnin dinastitë qeverisëse të Evropës dhe të vendosnin në vendet e tyre demokracinë. Nga ana tjetër, gjejmë atë që quhet lëvizja Anarkiste, një grup revolucionarësh nihilistë, të cilët donin të shëmbnin sistemin me shpresën që mirësia e njeriut në vetëvete do të krijonte diçka shumë më të mirë. Dhe kjo ekzistoi për afro 30 apo 40 vjet. U vu re një shtrirje nëpër të gjithë Evropën, madje edhe në Shtetet e Bashkuara, ku shpërthimet e veçanta anarkiste u shfaqën kryesisht në Çikago dhe Nju Jork dhe vende të tjera në SHBA. Në këtë kohë u realizuan një sërë vrasjesh të shumë sundimtarëve të huaj në të gjithë Evropën. Më pas, në shekullin e 20-të, vëmë re sërisht ndryshimin e terrorizmit, sidomos në pjesën e hershme të këtij shekulli, ku terrorizmi i atashohet jo vetëm lëvizjeve revolucionare - lëvizjeve që kërkojnë ndryshime thelbësore politike – por edhe me lëvizjet separatiste etno-nacionaliste të organizatave irredentiste. Me fjalë të tjera, me individë ose grupe individësh që përpiqen të krijojnë një vendlindje nisur nga aspekte historike, gjuhësore dhe kulturore të tyre. Fuqia e terrorizmit për të ndikuar në ngjarjet globale të asaj kohe u shfaq shumë qartë në prag të Luftës së Parë Botërore. Terrorizmi ishte ai që siguroi shkëndijën që shkaktoi shpërthimin e Luftës së Parë Botërore. Kjo korrespondoi me vrasjen në qershor të vitit 1914 të Kryepeshkopit Franz Ferdinand, trashëgimtar i fronit të Habsburgëve, pikërisht nga njëri prej revolucionarëve nacionalistë separatistë irredentistë i njohur si princi Gavril, i cili po përpiqej të shkëpuste Bosnjën nga Perandoria Habsburge dhe ta shpallte atë si një vend të pavarur. Pra, vihet re që koncepti i terrorizmit me kohën ndryshon, nga një fenomen i lidhur me qeverisjen gjatë Revolucionit Francez në një fenomen shumë të vendosur tek populli. Por

me interes janë vitet 1930, kur ai i rikthehet përsëri konotacioneve të lidhura me qeverinë dhe terrorizmi bëhet shumë i lidhur me abuzimet e pushtetit dhe shtypjen e popullsisë të shkaktuara nga Gjermania naziste dhe gjithashtu nga Rusia staliniste. Pra, ne e shohim terrorizmin tani më shumë të lidhur me qeveritë. Në 1950, pas Luftës së Dytë Botërore, edhe një herë, ai lëkundet në favor të aktorëve jo-shtetërorë. Terrorizmi bëhet shumë i lidhur me anti-kolonialistët, me nacionalistët, me popujt e botës në zhvillim që përpiqeshin të hidhnin poshtë lidhjet me imperializmin, për të liruar vendet e tyre nga sundimi Evropian.

Edhe një herë, ai bëhet revolucionar. Edhe një herë ai bëhet shumë nacionalist. Ai përsëri bëhet irredentist. Rikrijimi ose rivendosja e atdheut. Në vitet 1960 dhe '70 ai ndryshon përsëri. Mbetet shumë i përqendruar tek aktorët jo-shtetërorë duke pushuar lidhjet e tij me qeveritë. Tashmë ai i referohet, dy grupeve të veçanta terroriste ose revolucionare. Elementë të krahut të majtë radikal ose marksist dhe në të njëjtën kohë, të njëjtat grupe separatiste etno-nacionaliste që ekzistonin në fillim të shekullit dhe që rishfaqen në vende si Palestina, Irlanda, Spanja dhe vende të tjera.

Pra, konceptualizimet e terrorizmit ndryshojnë përsëri në vitet '80. Dhe përsëri, lavjerrësi lëkundet pak, por jo aq shumë sa për shembull ndodhi në vitet 1930. Por kjo përsëri e lidhur me qeveritë ose me shtetet e themeluara. Dhe në fillim të viteve 1980, terrorizmi shihet shumë si një fenomen që është orkestruar nga Moska dhe që zbatohet nga ish-Bashkimi Sovjetik dhe Pakti i saj i Varshavës ose favorizuesit e Bllokut Lindor si pjesë e një forme luftimi kundër Shteteve të Bashkuara në Perëndim. Nuk janë shumë organizatat terroriste individuale, sikurse mund të jenë organizatat radikale të krahut të majtë ose grupet separatiste revolucionare, por kontrolli i të gjitha këtyre entiteteve të cilat orkestrohen ose drejtohen nga një konspiracion qendror që del nga ish Bashkimi Sovjetik. E pra, me dobësimin e Bashkimit Sovjetik, humbjen e komunizmit në fund të viteve 1980, konceptualizimi i terrorizmit ndryshon përsëri. Është interesante se vazhdon t'i përmbahet dimensioneve shtetërore apo qeveritare.

Terrorizmi tani shihet shumë si një formë e luftës të shteteve kombëtare kundër superfuqive ose kundër armiqve të tyre. Pra, me fjalë të tjera, terrorizmi lidhet shumë me regjimin e kolonel Gaddafit në Libi, me regjimin e Sadam Huseinit në Irak për shembull, dhe dukej se ishte kjo formë e luftës surrogate ku shtetet po kontrollojnë terrorizmin aktualë. Në vitet 1990, ai ndryshon përsëri pasi, Lufta e Ftohtë ka mbaruar dhe Moska nuk mund të fshihet më pas kësaj. Sponzorizimi shtetëror vazhdon ende. Në të vërtetë, sponsorizimi i shtetit shihet tani si një promovim i një forme terrorizmi që në të vërtetë nuk ekzistonte që nga kohërat e lashta, siç ishte terrorizmi i motivuar nga një imperativ i spikatur fetar. Me fjalë të tjera, ku dhuna është legjitimuar ose justifikuar në bazë të parimeve teologjike. Pra, këtu bëhet mjaft e zakonshme. Sidoqoftë, vitet 1990 janë një dekadë e madhe konfuzioni ku për shkak të shtimit të tregtisë së narkomanëve në Amerikën Latine, veçanërisht në Kolumbi dhe Peru, terrorizmi lidhet tani me termin narcoterrorizëm dhe shihet si jo tërësisht politik, por gjithashtu i motivuar ekonomikisht. Me fjalë të tjera, individët janë të angazhuar në aktivitete kriminale në pothuajse një shkallë globale për të rregulluar xhepat e tyre. Në shekullin e 21-të, sidomos pas efekteve sizmike të sulmeve të 11 shtatorit 2001, kuptimi i terrorizmit, ndryshon gjithashtu në mënyrë radikale.

Në fakt ndërpritet përdorimi i termit terrorizëm. Fillon të flitet për Luftën kundër Terrorit. Kjo rezulton si një gabim i madh pasi "ism" në terrorizëm është jashtëzakonisht i



rëndësishëm. I-S-M do të thotë që terrorizmi është krejtësisht politik në karakter, se ka të bëjë kryesisht me ndryshimet politike. Kur fillohet të flitet për diçka si terrori dhe largohemi nga "ism", në këtë rast po i referohemi një emocioni. Në fund të fundit, kjo është ajo që terroristët duan që ne të bëjmë. Ata duan që ne të reagojmë emocionalisht, irracionalisht ndaj dhunës së tyre me shpresën se ata mund të përfitojnë nga këto përgjigje për të na detyruar ose për të na trembur. Pra, ne kemi një ndryshim të mëtejshëm të termit ku terrorizmi bëhet terror. Dhe gjithashtu kemi një fenomen ku herë pas here pas sulmit të 11 shtatorit luftohet kundër një taktike. Kjo vazhdon të quhet luftë kundër terrorizmit. Nga ana tjetër keni diskutime se si mund të eliminohet terrorizmi, kjo dukuri politike. Diskutimet realizohen në nivelet më të larta të qeverisë në Uashington duke folur për eliminimin e terrorizmit sikurse skllavëria dhe pirateria u eliminuan dikur në shekullin e 19-të. Natyrisht, problemi është se së pari, nuk mund të luftohet kundër një taktike. Lufta ndaj terrorizmit. Së dyti, nuk mund të luftohet kundër një emocioni. Lufta ndaj terrorit. Dhe së treti, skllavëria dhe pirateria te cilat fatkeqësisht dhe tragjikisht, ende ekzistojnë në mbarë botën. Pra, terrorizmi nuk është domosdoshmërisht një fenomen që mund të eliminohet ose të mposhtet krejtësisht. Dhe mendohet se kjo ka kontribuar edhe në vështirësitë tona në përcaktimin e diçkaje si terrorizmi.

Edhe pse domethënia e terrorizmit ka ndryshuar me kalimin e kohës, disa nga konceptualizimet themelore të terrorizmit kanë mbetur konstante gjatë dekadave. Së pari, qëllimi didaktik i terroristëve ose vlera didaktike. Kjo njihet si përdorimi i dhunës për të edukuar ose për të mbledhur masat. Përdorimi i dhunës nga terroristët për të tërhequr vëmendjen ndaj vetes dhe shkakut të tyre dhe për rrjedhojë, për të bërë publicitet duke shpresuar se mund të manipulojnë me qëllimin për të përfituar lëshime nga qeveria, për të frikësuar ose për të detyruar qeveritë që të japin të drejta politike të cilat në të kundërt nuk do ti kishin dhënë nëse nuk do të përballëshin me këtë dhunë. Ose thjesht për të futur çështjen e tyre në axhendën e botës. Dhe kjo është arsyeja pse njerëzit shpesh flasin se terrorizmi është diçka simbolike. Por kjo nga ana tjetër nuk do të thotë që viktimat e terrorizmit janë simbolike. Ka trupa të coptuar dhe kufoma që janë produkt i terrorizmit, shkatërrohen prona dhe ndërtesa. Dhuna, shkatërrimi dhe vdekja e shkatëruar janë pjesë e terrorizmit. Por kjo të çon në zemër e të kuptuarit se çfarë është terrorizmi, edhe pse mund të duket iracionale, në fakt, është mjaft e qëllimshme dhe është mjaft specifike. Është e paramenduar. Është përdorimi i dhunës kundrejtë objektivave simbolikë.

Me fjalë të tjera, këto objektiva simbolizojnë për terroristët evidentojnë armiqësinë e tyre ndaj një qeverie ose urrejtjen e tyre ndaj një populli tjetër ose një grupi tjetër rival etnik. Me fjalë të tjera, për ta nuk është aq shumë e rëndësishme viktimat sesa audienca e synuar. Për këtë arsye, ashtu sikurse propaganda e shekullit të 19-të ishte një pjesë e pandashme e terrorizmit, mbetet që terrorizmi të jetë një formë e komunikimit të dhunshëm. Është një formë e dhunës e përdorur nga individë të cilët nuk shpresojnë të përballen me vetë qeveritë më të fuqishme, por në vend të kësaj përdorin dhunën dhe veçanërisht frikën dhe kërcënimin që vjen nga ajo dhunë për të arritur qëllimet e tyre politike. Dhe kjo është arsyeja pse në përkufizimet e shumë personave në zemër të terrorizmit është fakti se është drejtuar kundër civilëve të pafajshëm. Me fjalë të tjera, është kjo ndjenjë e zëvendësimit për të cilën, cilido që ndodhet në vendin e gabuar në kohë të gabuar mund të bëhet viktimë e terrorizmit. Dhe kështu terroristët kërkojnë të përhapin frikën e tyre. Gjithashtu, nuk mund të lëmë pa shtuar edhe mënyrën sesi ata përpigjen të trembin qeveritë në pranimin e qëllimeve të tyre. Me fjalë

të tjera, nëse nuk pajtohet me atë që duan terroristët, dhuna do të vazhdojë dhe më shumë jetë të pafajshme do të humbasin. Le të kthehemi tek arsyeja e dytë pse terrorizmi ka qenë kaq i vështirë për tu përkufizuar. Kjo është shumë e thjeshtë në fakt, pasi studiuesit dhe ekspertët nuk bien dakord për një përkufizim.

Problematika është demonstruar shumë qartë gjatë viteve 1980, ndoshta në kulmin e terrorizmit modern ndërkombëtar. Kur u bë një sondazh i 100 ekspertëve kryesorë të fushës, nga këta 100 ekspertë u siguruan 109 përkufizime të ndryshme, që nënkupton se të paktën nëntë prej tyre nuk mund të pajtohen as me veten e tyre për sesi duhet të përkufizohet terrorizmi. Pra, kjo me të vërtetë tregon se sa e vështirë është të arrihet në një përkufizim të dakorduar të këtij fenomeni. Por megjithatë, nga këto 109 përkufizime, ne mund të nxjerrim disa koncepte kyçe thelbësore që janë me të vërtetë blloqet themelore në ndërtimin e përkufizimit të terrorizmit. Ka mbi një dyzinë konceptesh të identifikuara nga këta 100 ekspertë, por janë vetëm katër prej tyre për të cilat të paktën gjysma e ekspertëve bien dakord dhe që përbëjnë elementet themelore të natyrës së terrorizmit. Së pari, dhuna ose përdorimi i forcës. Pra, të gjitha përkufizimet e terrorizmit duhet të përfshijnë dhunën ose përdorimin e forcës. Së dyti, terrorizmi është në thelb politik. Ka të bëjë me arritjen e qëllimit themelor politik. Dhe kjo ka qenë një konstante që kur terrorizmi u përdor fillimisht në fillimet e tij me Revolucionin Francez. E treta është frika ose terrori, ankthi, shqetësimi që gjeneron kjo dhunë dhe që terroristët mendojnë se janë në gjendje të manipulojnë. Dhe pastaj i katërti është kërcënimi me një dhunë të vazhdueshme. Me fjalë të tjera, efektet ose pasojat psikologjike të terrorizmit sipas së cilave terrorizmi bëhet një fenomen i përhershëm në momentin që një person vihet në dijeni të një akti terrorist edhe në anën tjetër të globit. Kjo frikëson, shqetëson dhe brengos. Për këtë arsye terrorizmi është shumë i lidhur me sulmet ndaj civilëve të pafajshëm, sepse kështu zgjon mendimin që kjo është diçka që mund ti ndodhë kujdo. Në këtë formë terroristët kërkojnë të korrin dhe të shfaqin frikën duke manipuluar dhe duke e përdorur atë për të arritur objektivat e tyre thelbësore politike.

#### 1.2.4 EKSTREMIZMI I DHUNSHËM NË FAMILJE

**Lëvizjet e dhunshme të ekstremizmit në familje:** Ekstremizmi i dhunshëm në familje përkufizëohet si individë apo grupe që përpiqen të avancojnë bindje sociale ose politike nëpërmjet forcës ose dhunës dhe në kundërshtim me ligjin. Ka disa lëvizje të ekstremizmit të dhunshme në familje, duke përfshirë këtu, por pa u kufizuar në supremacistët e bardhë, të drejtat e kafshëve dhe eko-terroristët, dhe grupet anti-qeveritare ose radikalistët separatist. Nuk ka krime specifike të terrorizmit në familje, por individë ose grupe janë hetuar duke u bazuar në shkelje të veçanta penale. Shkeljet përfshijnë aktivitete të bazuara në urrejtje, shkelje në armëmbajtje ose posedim të një pajisje shkatërruese. Ndërsa disa të rritur përqafojnë ideologjitë ekstremiste të dhunshme në familje, besimet e tyre mund të përshkojnë normat familjare, shpesh duke ndikuar tek fëmijët e tyre. Kjo dinamikë nxit paragjykimet që çojnë në urrejtje dhe intolerance duke nxitur nevojën për veprim.

#### 1.2.5 KRIMET E URREJTJES

**Krimet e urrejtjes:** Krimi i urrejtjes është dhuna ose kërcënimi për dhunë bazuar në racën ose perceptimin e racës së viktimës, prejardhjes kombëtare, fesë apo një kategorizimi. Për shembull, Akti për Parandalimin e Krimeve të Urrejtjes të vitit 2009 i Mattheë Shepard dhe James Byrd Jr. e bën atë një krim që me qëllim shkakton ose tenton të shkaktojë lëndim trupor të një personi tjetër, bazuar në racën ose perceptimin e saj, fenë, ngjyrën, origjinën kombëtare, gjininë, paaftësinë ose orientimin seksual. Të përcaktosh një krim urrejtje si të

tillë do të thotë të ndalosh përdorimin e forcës ose kërcënimin me forcë për të ndërhyrë tek punësimi, strehimi, qasja ndaj strehimit publik dhe mbrojtja e të dejtave të tjera, bazuar në disa klasifikime të mbrojtjes, ose në ndërhyrje ndaj ushtrimit fetare.

### 1.3 MODELET E SJELLJES

Modele të shumta të sjelljes evidentojnë dinamikat dhe faktorët që çojnë në ekstremizmin e dhunshëm. Veçanërisht, ekstremizmi i dhunshëm nuk është një avancim linear, por një situatë dinamike në zhvillim që përfshin shumë faktorë, katalizatorë, frenues dhe variabla mobilizimi. Ekspertët e sjelljes supozojnë se përpjekjet e atyre që kërkojnë të luftojnë radikalizmin mund të informohen duke marrë parasysh modele të ndryshme të sjelljes dhe zhvillimit shoqëror, që përfshijnë:

- ❖ **Modeli Piramidë** – që promovon zhvillimin social të fëmijës nëpërmjet ndërhyrjes së hershme dhe parandalimin e vonesave sociale-emocionale ose shfaqjes së sjelljeve sfiduese. Një fëmijë në rrezik mund të shfaqë vonesa zhvillimore ose çrregullime, që rezultojnë nga një mjedis mbështetës me cilësi të ulët.
- ❖ **Teoria e Identitetit Social** - imazhi dhe statusi i një individi lidhet drejtpërdrejt me grupin të cilit i përketë, duke rezultuar në kategorizim social. Ndjenja e përkatësisë bëhet një faktor i rëndësishëm në krenari dhe vetëbesim. Tema qendrore është se anëtarët e grupit kërkojnë të gjejnë aspekte negative të grupeve të tjera, gjë që rrit imazhin e grupit të tyre, por gjithashtu mund të rezultojë në paragjykime, urrejtje dhe dhunë ndaj grupeve të tjera.
- ❖ **Modeli i Bandës me Sjellje Kriminale**- anëtari i një bande ndihet i de-individualizuar dhe i gatshëm të kryejë veprime të dhunshme në përputhje me sjelljen e bandës dhe ndjen përgjegjësi më të pakëta personale. Kjo ndarje nga vetja rezulton me më pak përgjegjësi dhe vetëdijësim të reduktuar, prandaj manifestohet në raste sjelljesh devijante.
- ❖ **Modeli i shkaktimit të delikuencës së të miturve** - një fëmijë është i ndjeshëm ndaj ndikimeve të dëmshme të përvojave familjare, socio-ekonomike, arsimore ose faktorët ideologjikë, duke rezultuar kështu shpesh në sjellje devijuese kriminale. Pasi ekspozohet ndaj normave jofunksionale, fëmija fillon të shfaqë sjellje që shkojnë në kundërshtim me pritshmëritë sociale.
- ❖ **Analiza e rrezikut të sulmeve terroriste** - një individ mendohet se është "në rrezik", kur janë të pranishëm tre elemente: kërcënimi për vlerat ose besimet kryesore, vulnerabiliteti dhe pasojat e veprimeve të tij. Këto tre elementë nuk janë të pavarur nga njëri-tjetri, por të gjitha duhet të jenë të pranishme që një individ të rezultojë "në rrezik". Shuma e këtyre tre elementeve është e barabartë me rrezikun që një individ të veprojë sipas qëllimeve të tij, duke u bazuar në motivimin, qëllimin, aftësinë, mundësinë dhe përfitimin psikologjik ndaj tyre. Një sfidë kryesore për shkollat tona është të kuptojmë katalizatorët e lidhur me sjelljen e nxënësit dhe të përcaktojnë formën e ekstremizmit të motivuar ideologjikisht që studenti ka përqaftuar.

#### 1.4 FORMAT KRYESORE TË EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Ekstremizmi i dhunshëm mund të kategorizohet në katër mënyra:

1. Dhuna nga krahu i majtë, siç janë veprimet e dhunshme të kryera nga grupet anti-kapitaliste për ndryshimin e sistemeve politike. Kjo kategori mund të përfshijë edhe dhunën nga ekstremistët për të drejtat e kafshëve ose grupet ambientaliste.
2. Veprime të dhunshme të krahut të djathtë, të tilla si ato të kryera nga grupet e ekstremit të djathtë, shpesh të referuara si grupe "neoNazi". Grupe të tilla janë të motivuara nga racizmi dhe dëshira për të mbrojtur epërsinë e supozuar raciale.
3. Dhuna me motive fetare, siç janë veprat e dhunshme të kryera nga lëvizjet ekstremiste islamike, të cilat shpesh kanë ankesa të veçanta kundër qeverive perëndimore në lidhje me politikën e jashtme.
4. Dhuna me bazë në një çështje, siç është dhuna e kryer nga grupet e interesuara për një çështje të vetme – siç mund të jetë aborti apo homoseksualiteti.

Incidentet e dhunës janë përsëritur thujse në një shkallë të ngjashme si nga grupet ekstremiste të krahut të djathtë ashtu edhe ato islamike në Evropë gjatë këtyre viteve të fundit. Megjithatë, kjo nuk pasqyrohet në perceptimet e publikut, pasi vëmendja e medias tenton të përqendrohet vetëm në disa incidente të caktuara. Ne të gjithë duhet të synojmë të bëhemi më të informuar duke pranuar se faktet mund të pësojnë shtrembërime nga media dhe mund të përdoret një terminologji që rrjedh nga supozimet diskriminuese ose që inkurajon stereotipizimin.

#### 1.5 SHKAQET E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Faktorët e mëposhtëm janë identifikuar nga hulumtimet si shkak për grupimet e dhunshme në mbarë botën. Ato janë tregues për shtimin e individëve që vendosin të përfshihen në fushata specifike dhune:

1. Ekzistenca e ankesave ose e padrejtësive të perceptuara nga një nëngrup i popullsisë.
2. Moshë dhe gjinia (aktet terroriste në përgjithësi kryhen nga meshkujt e rinj 15-25 vjeç).
3. Përfshirje pararendëse e familjarëve me ose në mbështetje të lëvizjeve.
4. Mbështetja e komunitetit për grupin e kryengritësve, ose statusi i lartë që lidhet me anëtarësimin në grup.
5. Shtrëngimi ose rekrutimi në lëvizje.
6. Anëtarësimi eventual si rezultat i procesit të shtimit të akteve kryengritëse.
7. Hakmarrja pasi individët ndjejnë nevojën për të goditur dhe për të korriguar gabimet ndaj së drejtës.

Për t'u bërë anëtar i një grupi të armatosur duhet të ketë një organizatë që individët të kenë mundësinë t'i atashohen dhe që e dëshiron anëtarësimin e tij ose të saj.

Ajo që vërehet nga kjo listë është se feja nuk përfshihet si një marrëdhënie e drejtpërdrejtë me dhunën. Është sugjeruar se ideologjia fetare mund të ketë më shumë të bëjë me lidhjen në grup të disa njerëzve së bashku. Në fund të fundit, fokusi në një sërë faktorësh të tillë si ideologjia fetare ose shëndeti mendor nuk na mundëson të shpjegojmë pse disa njerëz përfshihen në ekstremizmin e dhunshëm e disa jo. Shumë ekspertë pajtohen me faktin se nuk ka një rrugë të vetme për ekstremizmin e dhunshëm. Mund të

jetë më produktiv fokusi në pyetjen se si dhuna bëhet e ligjshme në mendjen e dhunuesit dhe, më e rëndësishmja, të shqyrtohen rrethanat politike dhe rrëfimet e natyrës politike të cilat janë të nevojshme që dhuna të shihet si legjitime.

## KAPITULLI II

### FAKTORËT E REZIKUT TEK TË RINJTË

#### 2.1 KATALIZATORËT QË DREJTOJNË EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM

Një sërë hulumtimesh të kryera nga praktikuesit e shëndetit mendor, akademikët dhe ofruesit e shërbimeve sociale, kanë dokumentuar tre kategori të rrezikut - faktorët e rrezikut tek adoleshentët, mjedisi dhe rreziku i `hyrjes` - që prekin rininë dhe zhvillimin e tyre të duhur kognitiv dhe fizik.

##### 2.1.1 PSE RREZIKOJNË TË REKRUTOHEN TË RINJTË?

Vlen të merret parasysh se çfarë përpiqen të arrijnë të riturit e përfshirë në grupet e armatosura duke rekrutuar të rinjtë në radhët e tyre. Duke i`u rikthyer perspektivave të ndryshme të të rinjve, shpesh është perspektiva e 'ngatrestarit' për të rinjtë që dominon diskutimin dhe arsyetimin mbi rekrutimin e tyre. Milicite nganjëherë shfrytëzojnë mënyrën me të cilën një komunitet percepton një të ri të veçantë ose grup të rinjsh si 'jashtë kontrollit' duke përdorur taktika të frikësimit për t'i sjellë nën kontrollin e tyre. Hulumtimet kanë treguar se të rinjtë mund të shihen si 'luftëtarë të lirë, të efektshëm dhe të bindur'. Të dhëna të regjistruara evidentojnë përfshirjen e dhjetëra mijëra ushtarëve fëmijë në shumicën e konflikteve të armatosura dhe pothuajse në çdo rajon të botës që nga viti 2000, me të rinjtë që shpesh kontrollohen dhe shfrytëzohen si ushqim për konflikte.

##### 2.1.2 FAKTORËT E RREZIKUT PËR ADOLESHENTËT

Adoleshenca shënon kalimin nga fëmijëria në moshën e ritur dhe shihet si një nga fazat më dinamike të zhvillimit njerëzor. Karakteristikat e adoleshencës përfshijnë ndryshime fizike, emocionale dhe intelektuale, si dhe ndryshime në rolet sociale, marrëdhëniet dhe pritshmëritë. Adoleshenca karakterizohet nga ripërcaktimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve me prindërit, familjen dhe moshatarët dhe përbëhet jo vetëm nga një fazë zhvillimore, por tri periudha të ndërlydhura:

#### **Periudha e Zhvillimit Sipas Moshës**

- Adoleshenca e hershme 10-14 vjeç
- Adoleshenca e mesme 15-17 vjeç
- Adoleshenca e vonët 18-24 vjeç

Çdo periudhë e adoleshencës përmban pritshmëri të natyrshme që shkaktojnë tek individit luhatjen e nevojave në mënyrë dramatike. Në të njëjtën kohë me luhatjen e nevojave, luhaten edhe faktorët e rrezikut të lidhura me to. Ka rreziqe që shoqërojnë hapsirat brenda shkollave nga armët, bandat, drogat, bulizmi, ngacmimet seksuale dhe çështjet zhvillimore që mund të rezultojnë në dhunë, duke përfshirë vetëvrasjen ose targetimin e të tjerëve. Shkollat e mesme përbëhen nga studentë nga secila periudhë zhvillimore e adoleshencës duke krijuar një dinamikë unike. Shkollat e mesme mund të jenë në rrezik më të madh dhe nxënësit mund të jenë më të ndjeshëm ndaj përqafimit të ideologjive ekstremiste të dhunshme, bashkimit me organizatat ekstremiste ose vetë-radikalizimit, nëse nuk janë në gjendje t'i përballojnë

faktorët ndikues dhe stresorët e përditshëm në jetën e tyre. Kjo dinamikë gjithashtu paraqet sfida unike për mësuesit - duke njohur dhe kuptuar katalizatorët themelorë ndaj sjelljeve ekstremiste të dhunshme dhe duke hartuar iniciativa rrënjësore për të ndihmuar studentët t'i rezistojnë tundimeve dhe joshjes së organizatave ekstremiste.

### 2.1.3 FAKTORËT E RREZIKUT MJEDISOR

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetit dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve sociale, ekspozimi i adoleshentëve ndaj faktorëve të rrezikut mjedisor ndikon në shëndetin dhe mirëqenien, aftësitë për t'i bërë ballë stresorëve të jetës, zhvillimit fizik dhe kognitiv dhe aftësisë së tyre për të marrë vendime të kujdesshme. Këta faktorë rreziku mjedisor përfshijnë ushqimin; prindërit dhe familja; lagjet dhe komunitetet; prejardhja kulturore; zona e shkollës; qasja ndaj organizatave qytetare ose shërbime sociale; mundësitë e punësimit; disponueshmëria e kujdesit të duhur shëndetësor; normave shoqërore dhe statusit socio-ekonomik. Një ose disa nga këta faktorë mund të ndikojnë në aftësinë përballuese të nxënësit dhe në pranimin e ideologjive të dhunshme ekstremiste. Shpesh, nxënësit zhgënjehen nga faktorë që janë jashtë kontrollit të tyre duke i hapur rrugë pakënaqësisë, zbrazjes, vetmisë ose ndjenjës së humbjes dhe braktisjes. Dallimet kulturore mund të intensifikojnë këto ndjenja që çojnë në izolim ose tjetërsim. Një mjedis edukues mund të ndihmojë një nxënës që të përballojë kërcënimin nga ekstremistët e dhunshëm, ndërkohë që një mjedis jofunksional mund të çojë në pranim më të madh apo aderim ndaj filozofive ekstremiste.

### 2.1.4 FAKTORËT E RREZIKUT `TË HYRJES`

Një artikull në Buletinin e Zbatimit të Ligjit të FBI-së, Ndërtimi i Rezistencës ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm - Një Perspektivë e Komunitetit, e datës prill 2014, përmendi një vlerësim të fundit kulturor të kryer mbi të rinjtë, prindërit dhe ofruesit e shërbimeve të bashkësisë në një komunitet të zgjedhur amerikan. Ky artikull përshkruan faktorët e rrezikut të hyrjes që krijojnë mundësi për t'u përfshirë në ekstremizmin e dhunshëm dhe sesi burimet mbrojtëse mund të ndalojnë, vonojnë ose zvogëlojnë mundësi të tilla. Një faktor rreziku hyrës përkufizohet si një mundësi që i jepet një individit për të lejuar hyrjen në një aktivitet ose për të filluar një sjellje negative jashtë kontrollit të miqve, familjes, kolegëve ose bashkëpunëtorëve. Këto rezultate sugjerojnë se aktivitetet parandaluese duhet të drejtohen në tre faktorë që kontribuojnë në përfshirjen e mundshme në ekstremizmin e dhunshëm:

- Koha e pallogaritur dhe hapësira e pakontrolluar;
- Legjitimiteti i perceptuar social i ekstremizmit të dhunshëm;
- Potenciali për kontakt me ekstremistët e dhunshëm

Secili prej këtyre rreziqeve ``Të Hyrjes`` kontribuon në përfshirjen fillestare të një nxënësi ose në lehtësimin e pranimin të ideologjisë së dhunshme që shpesh ndodh nga pikëpamja e familjes së tyre; që do të thotë, jashtë miratimit të tyre apo pëlqimit të drejtpërdrejtë. Hapësira e pakontrollueshme ose e pavrojtuar ofron një dritare mundësie për nxënësit që angazhohen në aktivitete në kundërshtim me normat ose dëshirat e familjare të tyre, duke krijuar kështu dobësi dhe mundësi shtesë për t'u ekspozuar ndaj ekstremistëve të dhunshëm ose retorikës së dhunës. Nxënësit në një hapësirë të pakontrolluar mund të kontaktojnë ose të kontaktohen nga një ekstremist i dhunshëm i njohur, i cili vlerëson të rinjtë për rekrutim të mundshëm të ardhshëm. Konsumi nga nxënësit i propagandës së dhunshme në hapësirën e pakontrolluar mund të ndezë radikalizimin dhe procesin e mobilizimit. Kufizimi i kohës së papunë dhe hapësirës së pakontrolluar siguron më pak kohë për t'u angazhuar në aktivitete negative.

Zëvendësimi i kohëve boshe me ndërveprime pozitive shoqërore mund të zvogëlojë aktivitetet në hapësirën e pakontrolluar. Ekstremistët e dhunshëm përpiqen të legjitimojnë veprimet e tyre si të përshtatshme dhe të nevojshme për të ndihmuar çështjen, ose të luftojnë për të mbrojtur kulturën, trashëgiminë ose besimet. Nxënësit mund të shikojnë me lehtësi tregime në transmetimet e vona të lajmeve, faqet e internetit ose forumet e mediave sociale, të cilat evidentojnë politikën e jashtme ose kombëtare. Këto tregime shërbejnë si katalizatorë ose nxisin pakënaqësitë ndaj organizatave ekstremiste. Nxënësit u japin kuptim këtyre konflikteve për ndërtimin e zgjidhjes dhe mbështesin thirrjet për veprim.

### 2.1.5 MEDIA SOCIALE

Inundacioni i ekstremizmit të dhunshëm në kulturën kryesore mund të përafrohet pjesërisht me përparimet teknologjike. Teksa teknologjitë e reja janë shfaqur, po ashtu kemi dhe përhapjen virtuale të ekstremizmit të dhunshëm. Aftësia e organizatave ekstremiste për të kapërcyer kufijtë gjeografikë mundësohet nga interneti dhe përdorimi i mediave sociale. Ekstremistët e dhunshëm kërkojnë për të rinjtë në mediat sociale ose forume online, për të vëzhguar, vlerësuar dhe rekrutuar ata që janë vulnerabël. Ky target i të rinjve gjithnjë e më shumë i vë ata "në rrezik", pasi shumë prej tyre janë në kontakt me teknologjinë dhe shpesh shpenzojnë sasi të mëdha të kohës në rrjetet e mediave sociale. Rinia e sotme varet fort nga media.

Një ese e vitit 2009 nga ish rekrutuesi i Al-Kaidës dhe kleriku militant Anëar Aulaqi e cilësoi internetin si një medium të madh për përhapjen e thirrjes së xhihadit dhe lajmërimet e muxhahedinëve. Aulaqi i`u referua internetit si EËË.Jihad dhe u kërkoi mbështetësve të krijojnë forume diskutimi në internet, faqes së internetit dhe listës së postës elektronike për të filluar biseda dhe për të zgjeruar komunitetet xhihadiste. Ky ndryshim në komunikimet ndërpersonale shpesh zëvendëson ndërveprimet normale ballë-për-ballë. Nevoja për lidhjen, pranimin ose ndjenjën e përkatësisë mund të orientojnë nevojat e tyre të përgjithshme, aktivitetet online dhe sferën e tyre shoqërore të ndikimit.

### 2.1.6 PROPAGANDA E DHUNSHME

**Propaganda me bazë në internet**-Interneti siguron qasje në rrjedhën e pafundme të propagandës së dhunshme që frymëzon për veprim, duke lavdëruar stilet e jetesës ekstremiste ose duke përshpejtuar përhapjen e urrejtjes dhe intolerancës. Dallimi midis fjalimeve të mbrojtura dhe nxitjes së paligjshme mund të jetë një vijë shumë e hollë. Ndalimi i anti-U.S, i mendimit ose i retorikës ekstremiste nuk është një krim dhe është i mbrojtur nga Amendamenti i parë i Amerikës. Çështja nuk është nëse individ shpreh mbështetjen e tij, por përkundrazi nëse ka mbrojtur dhunën në mbështetje të një organizate ekstremiste dhe se dhuna ka të ngjarë të ndodhë si rezultat. Ndërsa individët konsumojnë propagandë të dhunshme, mund të rezonojnë me ta ose të përforcojnë perceptimin e ankesave të tyre. Kjo rezulton në forcimin e besimeve dhe ndihmon zhvillimin e pikëpamjeve radikale ose gatishmërinë për të përdorur dhunën në mbështetje të një ideologjie ose ankese.



### 2.1.7 LOJA

**Loja Online**-shton edhe një nivel tjetër të dobësisë për rininë tonë. Në vlerësojmë se lojrat në internet nganjëherë përdoren për të komunikuar, trajnuar ose planifikuar aktivitete terroriste. Shumë të rinj janë shumë të aftë në teknikat e lojrave, në komunikimet online dhe në forumet e përdoruesve, duke çuar në ndërveprime me entuziastët e lojrave online, të cilët vlerësojnë të rinjtë e pambrojtur për mundësitë e mundshme të rekrutimit. Këto kontakte në internet mund të jenë përkrahës të një organizate ekstremiste dhe të rekrutuar në mënyrë aktive prej tyre. Një studim i vitit 2003 i kryer nga Universiteti Loyola në Chikago, sugjeron që lojërat online promovojnë ndërveprime sociale, zhvillojnë aftësi shprehëse, ndihmojnë në formulimin e strategjisë dhe promovon planifikimin në një mjedis të simuluar. Ambienti i lojrave lehtëson lidhjet shoqërore me të huajt që ndajnë interesa të përbashkët. Lojrat në internet mund të mësojnë gjithashtu protokollet rudimentare të luftës, rregullat e angazhimit dhe veprimet e tjera ushtarake, të cilat mund të aplikohen në skenarë të jetës reale të tilla si kryerja e një veprimi të dhunës të targetuar.

### 2.2 FORMAT E SHFAQJES SË DHUNËS

Ajo çka ndikon individët për të hyrë në rrugën e përdorimit ose mbështetjes së dhunës për të kërkuar një ndryshim, mund të jetë e vështirë të përcaktohet pasi mund të ketë një sërë faktorësh. Procesi i radikalizimit është unik për çdo person që i nënshtrohet dhe në shumicën e rasteve nuk do të shkaktojë dëme serioze. Megjithatë, në rrethana të jashtëzakonshme, vendimet e marra nga një i radikalizuar mund të rezultojnë në veprimtari serioze vdekjeprurëse të ekstremizmit të dhunshëm. Vendimet e të rinjve për t'u përfshirë në dhunë e organizuar të armatosur janë nga më të ndryshmet dhe këtu mund të përmendim:

**Një ndjenjë identiteti, përkatësie dhe pranimit** - personi i ri ndjen se po përfshihet dhe grupi mund të sigurojë një burim mbështetjeje. Kjo mund të jetë veçanërisht e rëndësishme për të rinjtë që ndihen të huaj ndaj një kulture mbizotëruese ose që mund të kenë frikë ose dyshime për shkak të besimeve, fesë apo për vendin ku jetojnë.

**Mbrojtje ose siguri** - Nga njëra anë, personi i ri mund të ndihet më i sigurt si anëtar i një grupimi specifik, veçanërisht nëse percepton një kërcënim nga jashtë lagjes ose nga një grupim tjetër. Nga ana tjetër, nëse zgjedhin të mos përfshihen, mund të ketë pasoja reale për të rinjtë. Për shembull, në Gjermani, të rinjtë që nuk janë pjesë e grupeve të krahut të djathtë në disa zona rurale mund të përjetojnë frikë dhe kërcënime për shkak të nivelit të dominimit nga një kulturë rinore e djathtë; disa mund të mendojnë se duhet të përfshihen për të qenë të sigurt.

**Status** - përfshirja në një grup të dhunshëm ose grup ekstremist mund t'i falë të rinjve ndjenjë se po mbrojnë familjen ose lagjen e tyre.

**Nder dhe përgjegjësi** - lidhja me një grup të organizuar të armatosur shpesh mund të çojë drejt të kuptuarit të sensit se çfarë do të thotë të jesh një qytetar i përgjegjshëm. Aktivitetet e grupimeve paraushtarake mund të bëhen dominante dhe të pranuar si normale në disa lagje, veçanërisht nëse ato shihen si zgjidhja e problemeve lokale në mënyrën më efektive sesa policia. Ato gjithashtu mund të sigurojnë një rrugë tjetër për të rinjtë, veçanërisht meshkujt e rinj, duke vepruar nisur nga ndjenja e shërbimit kundrejt komunitetit lokal. Një motiv tjetër për përfshirje mund të jetë frika e turp, veçanërisht për mosnjohjen e normave dhe

pritshmërive të përbashkëta, siç është nocioni gjinor rreth pritshmërisë se çfarë do të thotë të jesh burrë.

**Legjitimizëm-** aktet ekstremiste të dhunës mund të shfaqen në shoqëri ku ka një ndarje më të madhe midis bashkësive etno-fetare ose identiteteve politike. Ndarje të tillë krijojnë një ndjesi më të lartë të traditës dhe identitetit kulturor dhe çdo gjë që perceptohet si kërcënuese ndaj asaj kulture ose 'mënyre jetese' përforcon ndarjen midis 'atyre' dhe 'neve', si dhe frikën nga 'të tjerët'. Pjesëmarrja në grupe të armatosura të organizuara mund të shërbejë si justifikim për veprime diskriminuese dhe të dhunshme ndaj 'armikut'.

**Një mënyrë për të dalë nga varfëria**-veçanërisht për ata të rinj që jetojnë në komunitete që vuajnë nga deprivimi, përfshirja nëpër banda ose grupe paraushtarake mund të ofrojë një burim të ardhurash. Për disa, duke u bërë aktiv në një bandë të dhunshme ose në një grup ekstremist mund të konsiderohet si një karrierë alternative.

**Një ndjenjë fuqizimi dhe qëllimi** - personi i ri mund të ndiejë se kontributi i tij është i rëndësishëm dhe se vlera e tij konfirmohet nga roli që i jepet brenda një grupi të dhunshëm ekstremist.

**Një mundësi për të zgjidhur padrejtësitë** – pavarësisht të qenit lokale ose globale, disa grupime të dhunshme perceptohen pozitivisht pasi janë duke bërë diçka. Ky mund të jetë një faktor i rëndësishëm në komunitetet ku forca policore perceptohet si jo përfaqësuese dhe e angazhuar në praktika të padrejta (si për shembull profilizimi etnik) dhe për këtë arsye as nuk pranohet dhe as shihet si i efektshëm. Disa të rinj mund të mendojnë se të qenit pjesë e një organizate paraushtarake apo e një grupimi ekstremist është mënyra e tyre e vetme për të sfiduar pabarazitë ose diskriminimin që ata përjetojnë.

**Një mundësi për të 'luftuar'** - vendimi për t'u bashkuar me një organizatë ekstremiste mund të jetë në përgjigje të një ndjenje që është pjesë e një konflikti më të gjerë shoqëror, siç është perceptimi se myslimanët dhe feja islame janë të shenjestruar në shkallë globale, apo që refugjatët dhe azilkërkuesit duhet fajësohen për papunësinë dhe presionin në rritje mbi shërbimet publike.

**Hakmarrje** – në disa raste mjafton të ketë një incident shumë specifik, i cili të perceptohet si një sulm ndaj një grupi ose komuniteti të caktuar për ta çuar një të ri drejtë zgjedhjes për t'u bashkuar.

**Vizion utopik** - Ka disa dëshmi se gratë e reja, veçanërisht nënat e reja, janë ndikuar nga vizioni i një shoqërie utopike e cila është e çliruar nga krimi dhe varfëria, si një vend i sigurisë, barazisë dhe solidaritetit. Kjo ka motivuar disa gra të reja për të vajtur drejtë zonave të konfliktit të tilla si Siria, në mënyrë që të bashkohen me përpjekjet e Shtetit Islamik në ndërtimin e shteti.

**Për `pak gumëzhitje`** - ndjenja e eksitimit që disa të rinj përjetojnë si pasojë e përfshirjes së tyre në dhunë, siç është dhuna në rrugë, nuk duhet të nënvlerësohet - veçanërisht në komunitetet që nuk ofrojnë mundësi për të rinjtë apo ku grupet ekstremiste kërkojnë të nxisin dhunën duke organizuar demonstrata që rezultojnë në trazira civile.

### 2.2.1 IDENTIFIKIMI I TË RINJVE NË RREZIK

Kategorizimi i 'barometrit të sjelljes', është një udhëzues për vlerësimin e sjelljeve që mund të shërbejnë si tregues të procesit të radikalizimit të një individi. Këtu dallohet qartë, në njërën anë, aktivizimi jo i dhunshëm dhe demokratik dhe, nga ana tjetër, sjellja radikale që evidenton me fjalë ose veprime gatishmërinë për të përdorur dhunën.

#### SJELLJE TË PA RËNDËSISHME

Kjo kategori përfshin një sërë sjelljesh të lidhura me forma të ndryshme të angazhimit politik, fetar ose komunitar, të cilat karakterizohen nga veprime paqësore dhe me mjete demokratike të të shprehurit.

- Argumentim i zjarrtë për të mbrojtur bindjet para anëtarëve të familjes dhe / ose miqve të ngushtë.
- Adaptim i shenjave të dukshme (rrobat tradicionale, mjekra, kokën e rruajtur, simbole fetare, tatuazhet specifike, etj.) për të shprehur identitetin e tyre.
- Aktivizim në mediat sociale.
- Adaptim qëndrimesh dhe pjesëmarrje në fushata në mënyrë paqësore për një shkak që lidhet me një komunitet, një grup ose një individi.
- Interesim i madh për çështjet aktuale kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Dëshirë për të ri-integruar ose për të rritur përfshirjen në një praktikë fetare, ose një identitet apo angazhim politik.
- Konvertim ose miratim ndaj besimeve të reja fetare, ideologjike ose politike.
- Këmbëngulje për të ndjekur kërkesat specifike dietetike për shkak të bindjeve politike ose fetare.
- Dëshirë për t`I dhënë zgjidhje padrejtësive sociale

#### SJELLJE SHQETËSUESE

Kjo kategori përfshin sjelljet individuale që tregojnë dëshmi të problemeve shëndetësore. Këtu gjithashtu përfshihen sjelljet që përfaqësojnë një vetë-identifikim gjithnjë e më të madh me një shkak apo ideologji që e udhëheq individin të ndryshojë ndjeshëm sjelljen e tij.

- Shfaqje të pikëpamjeve polarizuese mbi të vërteta absolute, paranoja ose mosbesimit ekstrem.
- Miratimi i sjelljeve që krijon shikëputje me praktikën familjare.
- Tërheqje ndaj teorive dhe diskutimeve kospitacioniste.
- Izolim i vetes nga familja dhe / ose miqtë.
- Ndryshim i pa prituri i zakoneve.
- Paraqitje me këmbëngulje e ideve fetare dhe ideologjike për njerëzit e tjerë.
- Refuzim i rregullave dhe rregulloreve në institucionet dhe organizatat e kontaktit (shkolla, vendi i punës, klubet sportive, etj.) bazuar në baza ideologjike, politike ose fetare.
- Refuzim për të marrë pjesë në aktivitetet e grupit ose për të qëndruar në kontakt me individë të caktuar për shkak të fesë, racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë apo orientimit

	seksual të këtij të fundit. -Ndjenja viktimizimi dhe refuzimi. -Shprehje të nevojës për të dominuar ose kontrolluar të tjerët. -Vështirësi në rivlerësimin e ideve dhe / ose në njohjen e vlerës tek pikëpamjet e tjera.
--	---

Nisur nga parashtrimi i faktorëve të ndryshëm që mund të ndikojnë në vendimin e një të riu për të marrë pjesë në dhunën ekstreme, punonjësit e sektorit të të rinjve duhet të marrin parasysh atë çka u është parashtruar atyre dhe nevojat që po përmbushen nga grupimet ekstremiste. Ato duhet të synojnë të ofrojnë aktivitete që mund t'i plotësojnë këto nevoja në forma më pozitive dhe konstruktive. Në këtë kontekst, këto janë disa nga atributet thelbësore për punën me të rinjtë dhe të mësuarit joformal të tyre:

Mbështetja e të rinjve për të eksploruar identitetin e tyre; Sigurimi i ndjenjës së përkatësisë; Krijimi i hapësirave të sigurta për të rinjtë që të takohen dhe të jenë vetëvetja; Sigurimi i mundësive për të rinjtë për të sfiduar rrethanat negative që ndikojnë në jetën e tyre - si varfëria, diskriminimi ose papunësia; Mundësimi i të rinjve për të eksploruar alternativat e dhunës dhe për të imagjinuar mënyra të reja për zgjidhjen e problemeve

<p><b>SJELLJE SHQETËSUESE</b>                  Kjo kategori përfshin sjelljet që mund të lidhen me fillimin e angazhimit të një individi në një trajektore radikale. Ato karakterizohet nga një mosbesim i fortë ndaj botës së jashtme dhe nga një mbizotërim i pikëpamjeve që legjitimojnë përdorimin e dhunës për të arritur qëllimet, ose për të fituar kauzën</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Ndërprerje e lidhjeve me anëtarët e familjes dhe / ose me miqtë e ngushtë me qëllim mbajtjen e shoqërive ekskluzive me një rreth të ri të njohurish ose miqsh.</li> <li>-Legjitimimi i përdorimit të dhunës për të mbrojtur një kauzë apo ideologji.</li> <li>-Fshehja e një mënyre jetese të re, besnikërie ose besimi ndaj anëtarëve të familjes dhe / ose miqve të ngushtë (qoftë online ose në jetën reale).</li> <li>-Afërsi ndaj individëve ose grupeve të njohura si ekstremiste të dhunshme.</li> <li>-Pakënaqësi e papritur ndaj aktiviteteve profesionale ose shkollore.</li> <li>-Shfaqje e simboleve të përkatësisë ose mbështetjes që lidhet me grupe të njohura si ekstremiste të dhunshme.</li> <li>-Fiksuar me ide për fundin e botës.....</li> <li>-Shprehje e pikëpamjeve të urrejtjes ndaj individëve ose grupeve të tjera.</li> </ul>
<p><b>SJELLJE ALARMANTE</b>                  Kjo kategori përfshin një sërë sjelljesh që tregojnë dëshmi të një besnikërie ekskluzive dhe sektare ndaj një ideologjie ose një kauze, e cila e çon individin ta perceptojë dhunën si mjetin e vetëm legjitim dhe të vlefshëm të veprimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Pjesëmarrje në aktivitete të grupeve ekstremiste të dhunshme me çdo mjet të mundshëm (material, financiar ose fizik).</li> <li>-Rekrutim i individëve për çështje të dhunës ekstreme (ose inkurajim për t'u regjistruar për këtë arsye).</li> <li>-Kontakte me një grup ose një rrjet individësh të njohur si radikal të dhunshme,</li> </ul>

	<p>qoftë online ose ballë për ballë.</p> <p>-Përforcim i besimeve përmes konsultimeve të rregullta të forumeve dhe faqeve të internetit të dhunës ekstreme.</p> <p>-Kryerja ose planifikimi i veprime të dhunshme ose urrejtjes të frymëzuara nga motive ideologjike ose nga një shkak ekstremist i dhunshëm.</p> <p>-Të mësuarit rreth, të kërkuarit për të ditur se si përdoren armët (armë zjarri, eksplozivë, etj.) përtej kufijezimeve ligjore.</p>
--	--

## 2.3 KONFLIKTI, KUPTIMI I TIJ DHE AFTËSITË JETËSORE OSE TË BUTA. PARANDALIMI DHE MENAXHIMI I FORMAVE EKSTREME TË DHUNËS

### 2.3.1 PARAGJYKIMI, DISKRIMINIMI DHE KONFLIKT NDERMJET GRUPEVE

Termi paragjykim perdoret zakonisht per te identifikuar nje qendrim negativ karshi nje individi mbi bazen e perkatesise se tij sociale. Paragjykimi ka nje element te tij perberes **konjitiv** qe lidhet me opinionin dhe menyren e vleresimit te individeve dhe grupeve dhe nje element **emotiv**. Ky qendrim duhet te diferencohet nga sjellja e mirefillte qe vihet ne veprim karshi individeve dhe grupeve, e cila njihet me emrin « diskriminim».

Ne dia raste paragjykimi mund te jete prezent pa asnje forme diskriminimi per shkak te kufijezimeve te shumta normative. Nga ana tjetere, mund te kemi sjellje diskriminuese, ne disa raste edhe shume te dhunshme, pa u paraprire nga asnje forme paragjykimi si per shembull, rasti i bindjes ndaj pushtetit te grupit apo te nje autoriteti.

Me kalimin e kohes, nje paragjykim qe nuk mund te shfaqet ne formen e nje sjelljeje, mund te dobeshet deri ne zdukjen e tij si dhe gjithashtu, nje forme diskriminimi pa nje konflikt te mirefillte, ne shume raste mund te çojë ne paragjykim per nevojën e nje justifikimi te tij.

### 2.3.2 PERSONALITETI AUTORITAR

Sipas disa psikologeve, kryesisht me orjentim psikoanalitik, paragjykimet jane te lidhura me nje strukture te caktuar psikologjike te njohur si personaliteti autoritar.

Ky lloj personaliteti eshte rrezultati i eksperiencave feminore ne nje familje me disipline shume te hekurt. Te tille prinder krijojne tek femija ndjenja agresioni dhe urrejtjeje duke i bllokuar keshtu dhe ne lirshmerine e te shprehurit te instikteve te tyre seksuale. Urrejtja e provuar tek femijet ndaj prinderve reprimohet qe me mbrojtjen e tij ka tendencen t'i idealizojë duke perftuar keshtu qendrimin e nenshtruar ndaj figurave autoritare.

Nevoja per te shkarkuar energjine negative te akumuluar nga represioni prinderor, ben qe urrejtja te projektohet se jashtmi, kundrejt figurave me te dobeta.

### 2.3.3 PARAGJYKIMET DHE STEROTIPET

Disa teori mbi paragjykimet nenvizojne rendesine e proceseve konjitive ne formimin dhe mbajtjen e steriotipeve negative. Steriotipet mund te perkufijezohen si besime te perbashketa mbi bazen e te cilave pjesetaret e nje grupi social kane karakteristika te caktuara.

Te tilla konjicione harrojne aspektet dalluese te çdo individi dhe ata qe konsiderohen si pjesetar te nje grupi te caktuar, shihen si mbajtes te se njejtave karakteristika te perbashketa.

Kur shume persona ndajne te njejtin steriotip, ky mund te behet kaq i fuqishem sa te influencoje ne menyre te pavetedijshme perpunimin e informacioneve.

Nga stereotipet që pozicionojnë negativisht grupet shoqërore, lindin gjykime, emocione dhe veprime që transformohen në paragjykime dhe diskriminime.

### 2.3.4 TEORIA E DEPRIVIMIT RELATIV

Nivelet personale absolute të privimit janë më pak të rëndësishme në interpretimin e paragjykimit dhe të diskriminimit sesa privimi relativ.

Mospërputhja midis asaj që është arritur efektivisht dhe pritshmërive personale (pozicioni shoqëror i dëshiruar) përben privimin relativ: sa më e madhe të jete kjo mospërputhje, aq më i lartë është niveli i paknaqësisë dhe për pasoje aq më shumë rritet probabiliteti që paknaqësia të shpërthejë në paragjykim dhe konflikt kundër grupeve të vulnerabël.

### 2.3.5 PARAGJYKIMI SI FENOMEN I PËRFSHIRJES NË NJE GRUP

**Teoria e identitetit social**- duke u bazuar në rezultatet e studimit të Sherif, studimi i mëtejshëm i Henri Tajfel u përpoq të studionte nëse, të qenit në konkurrencë midis grupeve është një kusht sa i «mjaftueshëm» aq edhe i «domosdoshëm» për të lindur paragjykimet midis grupeve????

Tajfel zhvilloi një teknikë të caktuar studimi për të parë nëse diskriminimi shfaqet edhe nëse pjesëtarët e grupit nuk janë të përfshirë në marrëdhënie konkurrence dhe nuk ndërveprojnë midis tyre.

Studimi u krye mbi «grupet minimale» që janë grupet e ngritura mbi kriteret artificiale të përcaktuara nga studiuesi. Subjektet ishin nxënës nga 15-16 vjeç, që u ndanë mbi bazën e të ashtequajturave «preferencë estetike», në «grupin Klee» dhe «grupin Kandinsky». Detyra e pjesëmarrësve ishte të ndanin një shumë parashe midis dy subjekteve që i perkisnin dy grupeve eksperimentale. Subjektet ishin në dijeni të grupit të tyre por jo të identitetit të subjekteve midis të cilëve do të ndaheshin të ardhurat. Strategjitë që mund të zgjidheshin ishin: Paanshmeria; Përfitimimi më i madh i përbashkët; Diferencë maksimale në favor të grupit përfshirës dhe Përfitimimi maksimal i grupit përfshirës. Rezultatet treguan se shpesh here strategjia e përzgjedhur ishte ajoje diferencimit maksimal në favor të grupit përfshirës.

Përfshirja në një grup, edhe pse e përcaktuar mbi baze kriteresh të dobëta, prodhon favorizim për grupin përkatës në disavantazh të grupit të jashtëm. Teoria e identitetit social e Tajfel e shpjegon këtë «armiqësi në gjendjen fillestare» duke u nisur nga ideja se, dëshira për të kuptuar dhe për të vlerësuar veten, përben bazën e sjelljes shoqërore. Teoria thekson faktin se kjo dëshirë realizohet nëpërmjet kategorizimit dhe krahasimit shoqëror. Dëshira për një identitet social pozitiv dhe për nivele të larta vetëvlerësimi, bëjnë që paragjykimi të dalë si një aspekt i natyreshëm që evidenton natyrën e nevojave të tilla. Por favorizimi për grupin përfshirës nuk mund të jete një fenomen kaq i përgjithësuar për vetë faktin që pjesëtar të grupeve me status inferior janë më të prirur për të favorizuar grupet e jashtme të karakterizuara nga një status më i lartë.

### 2.3.6 TEORIA E KATEGORIZIMIT TE VETES

Teoria e kategorizimit te vetes u formulua nga John Turner. Kjo teori thekson faktin se tek individet ndodh nje transformim i kategorizimit te vetes nga nje nivel individual «identiteti personal» drejt nje kategorizimi te vetes ne nivel grupi «identiteti social».

Kur e konsiderojne veten si pjesetar ose jo te nje grupi social, individet sipas Turnerit i referohen perfytyrimit te pjesetarit ideal ose tipik te nje grupi: prototipi

Prototipat kane aftesine nga njera ane, te minimizojne dallimet e karakteristikave brenda grupit dhe, nga ana tjetere, te shtojne diferencat midis grupeve.

Kur kategoria e perfshirjes sociale behet me e vetedijshme, perceptimi i vetes shkon drejt nje «depersonalizimi» duke u bere me pak te vetedijshem mbi vecantite personale.

### 2.3.7 HIPOTEZA E KONTAKTIT

Allport ishte i pari qe theksoi rendesine e kontaktit midis grupeve si nje mundesi me efekte pozitive kunder paragjyqimeve. Sipas kesaj hipoteze, sjellja dhe qendrimet karshi grupeve te jashtme, mund te behen me tolerante ateher kur hyet ne marredhenie me te njejtet. Per kete qellim eshte me e pershtatshme qe kontakti te realizohet midis grupeve qe kane te njejtin status, qe ndjekin te njejtat objektiva dhe qe levizin sipas nje logjike bashkepunimi.

Nje element tjetere i rendesishem eshte mundesia qe grupet te bashkejetojne ne menyre paqesore, duke mbajtur gjithesecili identitetin e tyre specifik: ne kete rast realizohet nje proces integrimi (vs asimilimi) midis diversiteteve.

### 2.3.8 RIKATEGORIZIMI

Nisur nga fakti qe kategorizimet e vetes luajne nje rol te rendesishem ne formimin e identitetit social dhe individual, hipoteza e nxitjes se personave drejt kategorizimit te vetes duket si nje strategji e rendesishme per te luftuar paragjyqimet.

Ky tip rikategorizimi implikon faktin qe pjesetaret e ndryshem te grupeve te konsiderohen si pjesetare te nje kategorie superiore, duke u bere keshtu te gjitha pjese e nje grupi te vetem dhe duke zbuluar qendrimet dhe vlera te tjera te perbashketa pozitive.

## 2.4 ÇFARË NJIHET ME AFTËSI JETËSORE OSE TË BUTA?

Përkufizimi i aftësive jetësore (*Life Skills*) ose të buta përcaktohet si aftësi psiko-sociale që ndihmojnë individët të përballojnë sfidat e përditshme. Ka 16 aftësi jetësore të kategorizuara si më poshtë:

- ❖ **Aftësitë e njohjes dhe të ballafaqimit me VETËN, të cilat përfshijnë:**
  1. Vetëdijen.
  2. Vetëbesimin.
  3. Përballimi i emocioneve.
  4. Përballimi i stresit.
- ❖ **Aftësitë e njohjes dhe trajtimit me TË TJERËT të cilat përfshijnë:**
  1. Empatinë.
  2. Komunikimin efektiv.
  3. Marrëdhëniet ndërpersonale.
  4. Negocimin.
  5. Formimin e miqësive.
  6. Zgjidhjen paqësore të konflikteve.
  7. Këmbënguljen.
  8. Rezistencën ndaj presionit negativ të bashkëmoshatarëve.
- ❖ **Aftësitë për të marrë VENDIME efektive të cilat përfshijnë:**
  1. Vendimmarrjen.
  2. Të menduarit kreativ.
  3. Të menduarit kritik.
  4. Zgjidhjen e problemeve.

### 2.4.1 PËRFITIMET NGA AFTËSITË JETËSORE

Aftësitë jetësore shkojnë përtej ofrimit të njohurive dhe informacionit. Ato sigurojnë një themel që u mundëson të rinjve të përballen me sfida të ndryshme, si konfliktet dhe dhuna, duke njohur dhe menaxhuar situatat e rrezikshme përmes zhvillimit dhe mbajtjes së një sjelljeje pozitive.

Aftësitë specifike jetësore janë të rëndësishme për individin për këto arsye:

- Ato i mundësojnë individit që të shëndërojë njohuritë, qëndrimet, shkathtësitë dhe vlerat në aftësitë reale ose veprime reale që do t'i japin atij besimin për t'u marrë me konfliktet dhe për t'u mbrojtur nga dhuna.
- Ato rrisin pikëpamjet e njerëzve mbi veten e tyre duke çuar në vetëbesim, nderim dhe vetë-pranim. Një person i bindur dhe i sigurt do të shprehet më qartë, është në gjendje të thotë 'JO' për gjërat që ai e di se nuk janë të drejta, ndërsa në të njëjtën kohë do të jetë në gjendje të lidhen me të tjerët pa u frikësuar dhe duke zgjidhur mosmarrëveshjet në mënyrë paqësore.
- Aftësitë jetësore rrisin aftësinë e individit për të menduar në mënyrë kritike, për të marrë vendime të informuara dhe të përgjegjshme, ndërsa në të njëjtën kohë zgjidhin problemet në mënyrë më efikase. Kjo, pra, pakëson dobësinë e një personi për t'u abuzuar ose joshur dhe për t'u bashkuar me grupe të paligjshme dhe aktivitete që shkaktojnë dhunë dhe dëmtime për veten dhe të tjerët.

Përvetësimi dhe zbatimi efektiv i aftësive jetësore mundëson menaxhimin individual me sfidat e personaliteteve, miqve, anëtarëve të familjes, pjesëtarëve të shoqërisë dhe mjedisit në tërësi. Kjo mund të pasqyrohet në sektorë të ndryshëm si:

#### **Arsimi**

Të krijuarit e një atmosfere të favorshme për të nxënëit të karakterizuar nga marrëdhënie të mira, disiplinë, performancë të përmirësuar dhe të rinj që kanë një qëllim të qartë në jetë. Kjo zvogëlon ngacmimet dhe trazirat në shkolla.

#### **Shoqëria**

Të rinjtë do të ndihmohen në përzgjedhjen e miqve të besueshëm, përdorimin pozitiv të kohës së lirë dhe ndërtimit në ndërtimin e përgjithshëm të karakterit. Kjo do të çojë në një harmoni dhe ndërveprim kuptimplotë midis tyre dhe do të zvogëlojë dhunën.

#### **Shëndeti**

Mundësimin që individi të jetë i ndjeshëm ndaj shëndetit të tij / saj dhe shëndetit të njerëzve të tjerë dhe kjo do të kontribuojë në mirëqenien psikologjike, mendore dhe fizike që çon në një person të shëndetshëm.

#### **Kulturor**

Lejimin e të rinjve që të miratojnë dhe ndërmarrin praktika të shëndosha kulturore, të pranojnë diversitetin kulturor, duke zvogëluar konfliktet, keqkuptimet midis tyre dhe fqinjëve të tyre.



Në Përfundim:

1. Kur fëmijët e kuptojnë dhe e pranojnë veten, ata kanë më pak gjasa që t'i jepen presioneve negative të shokëve ose njerëzve që duket se u ofrojnë atyre pranim, një ndjenjë përkatësie dhe rëndësie. Kjo zvogëlon dobësinë e tyre ndaj dhunës ekstreme dhe formave të tjera të sjelljes së rrezikshme.
2. Aftësia për të thënë 'JO' bazuar në informacion, vlera dhe bindje të fituara edhe kur ndodh nën një presion të madh, do i ndihmojë fëmijët të mbrojnë veten nga shumë forma të rrezikut, përfshirë dhunën ekstreme.
3. Kur fëmijët janë në gjendje të përballen me lloje të ndryshme emocionesh dhe me stresin, ata nuk kanë gjasa të kërkojnë mënyra të rrezikshme për të adresuar nevojat e tyre emocionale.
4. Aftësia për të marrë vendime të përgjegjshme dhe të informuara dhe për të menduar në mënyrë kritike dhe kreative, rrit aftësinë e fëmijëve për të vlerësuar ekspozimin e tyre ndaj rrezikut të dhunës ekstreme dhe sjelljeve të tjera të rrezikshme. Këta fëmijë kanë më pak gjasa të joshen për t'u bashkuar me grupet ilegale, pasi ata janë në gjendje të peshojnë alternativat e ndryshme, të vlerësojnë pasojat e lidhura me to dhe me kreativitet të dalin nga rreziku dhe të kërkojnë ndihmë.
5. Aftësitë jetësore shkojnë krah për krah me vlerat e jetës. Këto vlera përfshijnë dashurinë, paqen, ndershmërinë, integritetin, unitetin, bashkëpunimin, respektin, përgjegjësinë, përvullësinë dhe tolerancën.

## KAPITULLI 3

### SHKOLLA SI QËNDËR KOMUNITARE

#### 3.1 ÇFARË ËSHTË SHKOLLA SI QËNDËR KOMUNITARE?

Shkolla qendër komunitare (SHQK) është një nismë e përbashkët që dallon për tërësinë e marrëdhënieve që lidhin shkollën, familjen dhe komunitetin. Ajo dallon për fokusin e saj në zhvillimin akademik të fëmijëve dhe të rinjve, angazhimin dhe kontributin qytetar, mbështetjen e familjes, shërbimet sociale me fokus sigurinë dhe Standardet e shkollës si qendër komunitare shëndetin si dhe shërbimet komunitare.

SHQK është një bashkëpunim mes aktorëve në komunitet, prindërve dhe shkollës, i fokusuar në:

- mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve dhe të rinjve,
- përmirësimin e arritjeve të tyre,
- mbështetjen e familjeve,
- zhvillimin e komuniteteve.

SHQK synon zhvillimin cilësor të shkollës dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rinjve si qytetarë të gatshëm dhe të aftë për të kontribuar në komunitetet e tyre. Sistemi arsimor Shqiptar ka nevojë për shkollat komunitare, sepse vëzhgimet e kryera dhe përvoja ka treguar që fëmijët dhe të rinjtë kanë nevojë për më shumë mundësi dhe mbështetje që të kenë sukses në studimet dhe veprimtaritë e tyre brenda dhe jashtë orarit mësimor. SHQK mbështetet në moton e të punuarit së bashku për një qëllim të përbashkët.

#### 3.1.1 VEÇORITË E SHKOLLËS SI QENDËR KOMUNITARE

- SHQK konsiderohen ato institucione arsimore, të cilat i shërbejnë jo vetëm komunitetit shkollor (nxënës dhe mësues) por janë të hapura dhe në shërbim të gjithë anëtarëve të komunitetit.
- SHQK janë institucione të cilat ngrenë dhe zhvillojnë punën e tyre bazuar në nevojat e nxënësve, të familjeve dhe komunitetit;
- SHQK ofrojnë një sërë shërbimesh, pas orarit mësimor, për nxënësit, familjet dhe komunitetin;
- SHQK pranojnë prindërit si bashkëedukatorë dhe angazhojnë ata në vendimmarrje të përbashkëta;
- SHQK sigurojnë kohezionin social;
- SHQK ngrihen mbi pikat e forta të komunitetit.

#### 3.1.2 PSE NGRIHEN SHKOLLAT SI QENDRA KOMUNITARE?

Shkolla duket se është transformuar në një institucion të mbyllur dhe të fokusuar vetëm në një funksion, atë të mësimdhënies dhe nxënies. Sot shumëkush e sheh atë si ishull të izoluar nga komuniteti. Shndërrimi i shkollave në qendra komunitare bën që ato të funksionojnë dhe të perceptohen si institucioni ku ndërveprohet, bashkëpunohet dhe krijohet. Shkollat, familjet dhe komuniteti sot përballen me një sfidë të përbashkët: edukim cilësor për fëmijët e të rinjtë si dhe mundësi për t’iu përgjigjur nevojave të tyre përtej përgatitjes akademike. Fëmijët dhe të rinjtë duhet të njohin dhe të mbajnë qëndrim për çështjet dhe problematikat sociale të komunitetit. Partneriteti me aktorët e tjerë krijon mundësinë e ngritjes dhe realizimit të

projekteve me tematika të përbashkëta Standardet e shkollës si qendër komunitare duke mundësuar gjetjen e rrugëve për zgjidhjen e tyre dhe aftësuar nxënësit për të kontribuar për komunitetet e tyre

### 3.1.3 PARIMET BAZË QË UDHËHEQIN SHKOLLËS SI QENDËR KOMUNITARE

- Sigurimi i një arsimit cilësor për çdo nxënësi.
- Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale, shëndetësore të nxënësve.
- Angazhimi dhe zhvillimi i komunitetit.
- Vendimmarrja e përbashkët.
- Respektimi i diversitetit.
- Përdorimi i burimeve komunitare në shërbim të shkollës.

### 3.1.4 VEPRIMTARI TË SHKOLLËS SI QENDËR KOMUNITARE

Veprimtari për zhvillimin akademik të nxënësve – Shkolla si qendër komunitare ofron programe dhe shërbime që sigurojnë mbështetje dhe zhvillim akademik për nxënësit dhe të rinjtë, duke plotësuar programin mësimor.

Ka disa rrugë për të mbështetur zhvillimin akademik të nxënësve:

- Veprimtari për përforsim të të nxënësit. Këto veprimtari bëhen për të zotëruar më mirë aftësitë që nxënësi po mëson në klasën e tij siç janë konsultimet lidhur me lëndët.
- Veprimtari për pasurimin e zhvillimit akademik. Këto kurse/klube ngrihen mbi përmbajtjen e lëndës që nxënësi po zhvillon në klasën e tij dhe thellojnë dijet në një fushë të caktuar kurrikulare apo dhe fushave të tjera kurrikulare.

Shkolla ndërton kurse akademike (si kurset e shkencës, kurse plotësuese për nxënësit me vështirësi, etj), të cilat nuk i mbivendosen programeve dhe përvojave të nxënësit në orën e mësimin.

Shkolla ngre klube në mbështetje të thellimit dhe plotësimit të njohurive të tij në fusha të ndryshme apo të zhvillimit të të menduarit kritik (si klubet e debatit, klubet e leximit, klubet fjalës poetike etj).

Veprimtari për zhvillimin artistik, kulturor dhe sportiv – Shkolla si qendër komunitare mundëson që programet dhe shërbimet që ajo ofron t’i adresohen nevojave të zhvillimit fizik, mendor, emocional dhe social të nxënësve. Nxënësit gjejnë në shkollë informacionin dhe mjetet për përmbushjen e këtyre nevojave.

Veprimtari që nxisin këtë aspekt të zhvillimit të nxënësve janë:

- Veprimtaritë sportive si volejball, basketboll, futboll, aerobi, etj
- Veprimtari kulturore si teatër, muzikë, kërcim, dramë, recitim, stilim, pikturë, etj

Veprimtari për angazhimin dhe mbështetjen e familjes – Shkolla si qendër komunitare i konsideron prindërit si partnerë dhe burim të rëndësishëm. Ajo krijon një klimë pozitive, mirëseardhje dhe bashkëpunimi, si dhe ndërton programe për përfshirjen e prindërve.

Këto mund të jenë veprimtari që:

- ndihmojnë prindërit të ndjekin përparimin e fëmijës. Shkolla është tërësisht transparente para prindërve. Të tilla veprimtari janë, fletët informuese për prindërit, ditari i nxënësit, takimet periodike me mësuesit, etj
- ndihmojnë prindërit të mbështesin fëmijët e tyre dhe shkollën si institucion, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit në shkollë. Të tilla veprimtari janë përfshirja në vendimmarrje përmes marrjes pjesë në organizma të shkollës (bordi I shkollës, këshilli i prindërve, etj), pjesëmarrjes në planifikimin e veprimtarive në shkollë (plani afatmesëm dhe vjetor i shkollës, projekte të shkollës, etj), pjesëmarrja në programe për të nxënin e nxënësve apo të rriturve (kurse kompjuteri, kurse për zhvillimin e aftësive të thjeshta profesionale, programe për ndihmën që mund të japin prindërit për nxënësit që kanë vështirësi, etj).
- plotësojnë nevojat e prindërve. Këtu përfshihen veprimtari ku prindërit shfrytëzojnë burimet që ofron shkolla (biblioteka, kompjuterët dhe interneti, mjediset dhe pajisjet sportive, etj) si dhe veprimtari ku prindërve shkolla I ofron ekspertizën e saj për të plotësuar një nevojë në një fushë të caktuar (kurse kompjuteri, gjuhë të huaj etj)

Veprimtari për angazhimin e komunitetit – Shkolla si qendër komunitare bashkëpunon ngushtë me komunitetin dhe mundëson programe, shërbime dhe mbështetje për anëtarët e komunitetit. Kjo shërben si burim për të nxënit e komunitetit dhe shfrytëzimin e burimeve të komunitetit për zhvillimin e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve. Shkolla përdor rrugë të ndryshme për të bashkëpunuar me komunitetin.

Këto mund të jenë veprimtari:

- për të sjellë shërbimet dhe programet e komunitetit në shkollë. Në këtë rast shkolla vlerëson dhe shfrytëzon asetet e komunitetit si organizata dhe institucione, qendra të shëndetit fizik e mendor, institucione të arit dhe kulturës, biznese, etj.
- që fokusohen në projekte të përbashkëta që ndihmojnë shkollën dhe shërbimin komunitar.
- për të plotësuar nevojat e komunitetit. Këtu përfshihen veprimtari ku si prindërit, pjesëtarë të tjerë të komunitetit shfrytëzojnë burimet që ofron shkolla.

### 3.2. Ç’JANË STANDARDET E SHKOLLËS SI QENDËR KOMUNITARE?

Standardet e shkollës si qendër komunitare janë një përmbledhje e karakteristikave më themelore që duhet të ketë një shkollë për të përmbushur misionin e saj si vendi ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe bashkëpunohet për zhvillimin e potencialit të plotë të çdo nxënësi, të shprehura nëpërmjet treguesve përkatës, për të cilat është siguruar një miratim dhe rënie dakord në shkallë të gjerë nga komuniteti edukativ dhe nga institucionet shtetërore. Standardet paraqiten të ndara në disa grupime (fusha) dhe shprehen nëpërmjet treguesve të detajuar, që, nga ana e tyre, provojnë përmbushjen e standardeve nga shkolla. Standardet e paraqitura janë standarde bazë, në kuptimin që ato duhet t’i përmbushë secila shkollë për tu quajtur si shkollë komunitare.

### 3.2.1 PSE NEVOJITEN STANDARDET E SHKOLLËS SI QENDËR KOMUNITARE

Qëllimi kryesor i hartimit të këtyre standardeve është të ndihmojnë në përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënies, si dhe në tërë procesin e edukimit të nxënësve nëpërmjet partneritetit shkollë-familje-komunitet.

Përdoruesi i parë dhe më kryesor i standardeve është shkolla.

Standartet i vijnë në ndihmë shkollës:

- Të ndërmarrë veprimtari për identifikimin e nevojave dhe përcaktimin e prioriteteve, për të mbështetur të nxëniet e nxënësve dhe përmirësuar arritjet e tyre.
- Të identifikojë pikat e forta dhe të dobëta, të cilat sigurojnë informacionin e nevojshëm për planifikimet strategjike.
- Të përcaktojnë fokusin e punës me partnerët dhe aktorët e tjerë.
- Të sigurojë feedback të vazhdueshëm nga nxënësit dhe familjet për të ndërtuar marrëdhënie të fuqishme me ta.
- Të vlerësojë dhe rishikojë cilësinë e marrëdhënieve me komunitetin.

### 3.2.2 FUSHAT E STANDARDEVE

1. Sigurimi i arsimit cilësor për çdo nxënë
2. Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale, shëndetësore të nxënësve
3. Angazhimi dhe zhvillimi i komunitetit
4. Vendimmarrja e përbashkët
5. Gjithëpërfshirja dhe respektimi i diversitetit

### 3.2.4 STANDARDET E SHKOLLËS SI QENDËR KOMUNITARE

**FUSHA: SIGURIMI I ARSIMIT CILËSOR PËR ÇDO NXËNËS** Shkolla, familja dhe komuniteti bashkëpunojnë për të mbështetur, pasuruar dhe nxitur të nxëniet e fëmijëve dhe të rinjve, përmes veprimtarive formale dhe joformale, brenda dhe jashtë shkolle. Shkolla integron programe dhe shërbime që mbështesin zhvillimin akademik të nxënësve dhe plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre.

Standardi 1: Përbushja e nevojave dhe interesave të nxënësve

Standardi 2: Monitorimi dhe vlerësimi i performancës së shkollës

Standardi 3: Cilësia e mësimdhënies

### **FUSHA: SIGURIMI I MIRËQENIES SOCIALE, EMOCIONALE DHE SHËNDETËSORE TË NXËNËSVE**

Shkolla, bashkëpunon me prindërit dhe partnerë të tjerë të komunitetit për të njohur, adresuar dhe përbushur nevojat fizike, emocionale dhe sociale të nxënësve dhe për të garantuar zhvillimin e tyre të shëndetshëm. Ato, së bashku, ofrojnë programe (që përfshijnë veprimtari

fizike, e sportive, programe për të ushqyerin e shëndetshëm, veprimtari kulturore etj.) të cilat kontribuojnë në përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe të klimës në shkollë.

Standardi 1: Mbështetja e zhvillimit social, emocional dhe shëndetësor të nxënësve

Standardi 2: Mbrojtja dhe mekanizmat e referimit

Standardi 3: Mjedis fizik i shkollës

**FUSHA: ANGAZHIM DHE ZHVILLIM I KOMUNITETIT.**

Shkolla ofron shërbime që shërbejnë për zhvillimin e komunitetit, dhe komuniteti është pjesë përbërëse e aktiviteteve që organizon shkollë. Në këtë mënyrë nuk përfton vetëm komuniteti nga shkolla por dhe shkolla bashkëpunon me komunitetin për rritjen dhe përmirësimin e rezultateve për nxënësit. Prania e prindërve në shkollë dhe njohja me nevojat e nxënësve do të thotë më pak stres për familjarët dhe rezultate më të larta për nxënësit.

Standardi 1: Prania e prindërve në shkollë

Standardi 2: Shkolla ofron zhvillim për komunitetin

Standardi 3: Krijimi i kushteve që mundësojnë zhvillim të përbashkët

Standardi 4: Financimi i kurse që ofrohen për komunitetin dhe nga komuniteti

Standardi 5: Prindërit janë të përfshirë në planifikimin, menaxhimin, vlerësimin implementimin dhe aprovimin e programit në oraret jashtë shkollore.

**FUSHA: VENDIMMARRJA E PËRBASHKËT**

Prindërit, komuniteti dhe stafi i shkollës janë partnerë të rëndësishëm dhe të barabartë në vendimmarrjet që ndikojnë në cilësinë e shkollës dhe arritjet e nxënësve. Ata së bashku mund të informojnë, ndikojnë dhe krijojnë politika, praktika dhe programe në dobi të suksesit të nxënësve.

Standardi 1: Planifikimi strategjik i institucionit arsimor

Standardi 2: Drejtimi i institucionit arsimor

Standardi 3: Organizmat e institucionit arsimor

Standardi 4: Zëri komunitetit në vendimmarrjen e përbashkët

**FUSHA: GJITHËPËRFSHIRJA DHE RESPEKTIMI I DIVERSITETIT**

Shkolla u siguron të gjithë fëmijëve të drejtën themelore për arsim dhe mundësi të barabarta pa dallim të origjinës, identitetit kulturor, gjuhës, aftësive, apo rrethanave ekonomike, respektim të vlerave e shoqërisë, të bashkëjetesës në shoqëri, si dhe të qenit qytetar aktiv në botën e ndërvarur.

Standardi 1: Respektimi i të drejtave të fëmijëve

Standardi 2: Mundësi të barabarta për t'u regjistruar në shkollë, për ta ndjekur dhe përfunduar atë.

Standardi 3: Përshtatja me nevojat e zhvillimit të fëmijës

Standardi 4: Mjedisi pa pengesa

Standardi 5: Infrastruktura e disponueshme për personat me aftësi të kufizuar

Standardi 5: Infrastruktura duhet të jetë e disponueshme nga të dy gjinitë

Standardi 6: Qeverisja e shkollës

Standardi 7: Veprimtaritë mësimore

“Ky dokument është prodhuar në kuadër të projektit “A Caravan for Social Challenges! A Caravan for your empowerment” i zbatuar nga “Open Doors” mbështetur financiarisht nga projekti “Shoqëria Civile kundër Ekstremizmit të Dhunshëm” i cili financohet nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Open Doors dhe në asnjë rast nuk reflekton apo përfaqëson domosdoshmërisht mendimin apo qëndrimin e KSHH-së dhe as të Bashkimit Evropian”